



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni i Posaçëm Parlamentar “Për shqyrtimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve të organeve drejtuese të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve”*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 29.09.2020, ora 15:00

**Drejton mbledhjen:**

**Damian Gjijknuri – kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar**

**Rendi i ditës**

Seancë dëgjimore me kandidatët që i plotësojnë kriteret për pozicionet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve; Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve

**Marrin pjesë:**

Damian Gjijknuri, Adnor Shameti, Alket Hyseni, Myslim Murrizi, Edmond Stojku dhe Oerd Bylykbashi.

## HAPET MBLEDHJA

**Damian Gjikhuri** – Mirëmbërëma, të nderuar anëtarë të komisionit!

Dje në vendimmarrjen që patëm bëmë selektimin e parë të kandidatëve, që plotësonin kriteret formale sipas procedurave të Rregullores së Kuvendit, por edhe të asaj që kemi vendosur. Sot është momenti për të thirrur kandidatët, që kanë shprehur interesin dhe që janë kualifikuar për sa u përket kriterëve formale, që të bëjnë një prezantim të tyre.

Meqenëse ka shumë kandidatë kërkoj mirëkuptimin e anëtarëve që të mundohemi t'i mbajmë sa më shkurt, përveç rasteve kur kanë ndonjë çështje me interes, e cila mund të zgjojë pyetje dhe debate të mëtejshme. Pra, kemi të bëjmë me shumë kandidatë dhe vetëm sot në mos gaboj janë 26, ndërsa nesër do të vazhdojmë me pjesën tjetër.

Fillojmë me kandidatin e parë zotin Admir Drago.

Zoti Drago, na flisni shumë shkurt për veten tuaj, duke u fokusuar te marrëdhëniet që ke pasur në lidhje me pozicionet që ke ushtruar, Përse ke shprehur dëshirën për të aplikuar në një nga pozicionet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe nëse ke ndonjë ndalesë si anëtar i ndonjë partie politike apo ndonjë konflikt interesi me partitë politike, pra në favor të vendimmarrjeve që mund të kesh.

**Admir Drago** – Përshëndetje!

Quhem Admir Drago. Kam lindur dhe banoj në Tiranë. Kam studiuar për drejtësi në Universitetin e Tiranës, por kam mbaruar edhe disa shkolla pasuniversitare jashtë shteti. Prej vitit 2003 kam ushtruar profesionin e juristit në disa institucione private dhe shtetërore. Aktualisht punoj si noter.

Kam paraqitur kandidaturën time këtu, sepse mendoj që është një institucion interesant dhe i ri. Duke marrë pjesë këtu mendoj se mund të jap kontributin tim si pjesë e tij, me eksperiencën dhe profesionalizmin që kam arritur deri tani.

Gjatë eksperiencës time kam punuar jashtëzakonisht shumë për të drejtat e njeriut, duke u marrë që në rini me organizata rinore, të cilat kanë pasur në fokus mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Edhe në punën time si avokat, gjithsesi kuptohet që pjesë e përfaqësimit është mbrojtja e një të drejte të shkelur apo të mohuar. Kam punuar në administratë të lartë shtetërore, ku kam qenë këshilltar i Kryeministrit dhe aty jam marrë me draftime ligjesh, projektligjesh që kanë pasur në fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfaqësimin apo edhe monitorimin e mosshkeljes së të drejtave nga institucionet shtetërore.

Nuk kam konflikt interesi dhe nuk jam anëtar i asnjë partie.

**Damian Gjijnuri** – Meqenëse jeni noter, do të thotë se keni një punë me angazhim të plotë. E shikoj që keni aplikuar edhe për komisioner, doja të dija a jeni të gatshëm ta lini detyrën e noterit për ushtrimin e pozicionit të komisionerit, kurse të tjerat janë *partime* dhe mund të bëhen?

**Admir Drago** – Ligji i ri i noterisë, i miratuar në vitin 2018 nga ky parlament, e ka përshkruar që profesioni i noterit mund të ndërpritet për një periudhë të caktuar kohe. E parë në këndvështrimin e një funksioni publik, ndjekja e një karriere përsëri në administratën publike brenda KQZ-së, mund të jetë përsëri brenda të njëjtës linjë të shërbimit publik, prandaj nuk e shikoj si çudi ndërprerjen e noterisë.

**Alket Hyseni** – Dua ta falënderoj zotin Drago për kandidimin e tij. Unë e kam parë edhe CV-në, përveç njohjes time, dhe më duket një kandidat i kompletuar.

**Oerd Bylykbashi** – Unë e njoh personalisht zotin Drago. Ai ka qenë këshilltar ligjor dhe ka pasur në fokus të veçantë legjisllacionin që kalonte ndërmjet Këshillit të Ministrave. Për rrjedhojë, ai i plotëson të gjitha kriteret në lidhje me aplikimin në të gjitha pozicionet që është paraqitur.

**Damian Gjijnuri** – Kandidati tjetër është Agim Paskali.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Dakord, atëherë Agron Haxhimali.

Agron, mirë se erdhe!

Të lutem, shumë shkurt na trego se çfarë të shtyu të aplikosh për pozicionet e KQZ-së, pak për veten tuaj dhe çfarë mendon se mund të bësh në atë punë nisur edhe nga pozicioni delikat që ofron ai institucion.

**Agron Haxhimali** – Unë jam Agron Haxhimali.

Kam lindur dhe jam rritur në Petrelë dhe aktualisht banoj në Tiranë. Jam i diplomuar në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, dega Biologji-Kimi. Unë kam punuar 3 vjet drejtor në një gjimnaz, kam qenë 4 vjet kryetar komune, më pas kam punuar me projekte ndërkombëtare; kam qenë drejtor i Shoqatës së Komunave, aktualisht jam drejtor i Shoqatës së Bashkive. Pse vendosa të jem sot këtu? Jam këtu për dy arsye: së pari, në pikëpamjen minimaliste për të respektuar thirrjen e komisionit, si dhe për t'iu përgjigjur thirrjes së Kryetarit të Kuvendit që duhet të aplikojmë. Unë vendosa të aplikoj si qytetar i përgjegjshëm dhe jo për të plotësuar numrin, sepse kapaciteti im, aftësitë e mia, eksperiencia ime në administratën publike, si dhe marrëdhëniet ndërinstitucionale që kam pasur me bashkëpunëtorë brenda dhe jashtë Shqipërisë më kanë dhënë aftësi dhe kapacitete që mund t'i administroj, të menaxhoj institucione të reja, si dhe të bëhem pjesë e institucioneve të reja,

siç është rasti i KQZ-së së re. Unë i kuptoj shumë mirë problemet që janë mbartur në KQZ, e cila në përgjithësi ka mbajtur një barrë të debatit qytetar, një mosbesueshmëri që është ngarkuar nga publiku qoftë me të drejtë apo pa të drejtë, por qoftë edhe nga politika. Unë mendoj se është një rast i mirë, sepse një institucion i ri ka nevojë për fytyra të reja, ka nevojë për njerëz të angazhuar dhe për kapacitete që vijnë nga shoqëria civile, siç është rasti im, që gjithmonë në punën e tyre kanë pasur vetëm rezultate pozitive dhe gjithmonë kanë drejtuar me objektivitet, kanë qenë gjithëpërfshirës dhe asnjëherë nuk janë kontestuar në vendimmarrjet e tyre dhe ky është qëllimi.

Vetëm për dy sekonda mund t'ju them se si e mendoj unë pozicionin tim në dy etapa për ta zgjidhur dhe për ta konsoliduar këtë institucion.

Hapi i parë është që të organizoj një administratë institucionale me burime njerëzore të afta, të cilat duhet ta kryejnë punën e tyre pa u kontestuar dhe në shërbim të të gjithë procesit zgjedhor.

Hapi i dytë është se këtë administratë të re do ta vendos në funksion të të gjithë procesit, që është emergjencë për zgjedhjet e ardhshme. Sigurisht, nga pozicioni im do të kërkoj ndryshime dhe adaptim të kuadrit ligjor, me qëllim që këtij institucion i ri të mos i mungojë kuadri ligjor, të ketë rregullat dhe udhëzimet që parlamenti vendos, të cilat të jenë funksionale dhe sa më të thjeshta për të operuar komisioni. Pra, këto janë te grupi i punëve të para.

Në etapën e dytë, duke qenë se është një institucion i ri, qytetarët shqiptarë, publiku, politika brenda dhe jashtë vendit po presin që në këtë institucion, gjë për të cilën unë do të angazhohem personalisht, të mos ndihen më zhurmat, debatet, pikëpyetjet për vendimmarrjen e tij. Pra, absolutisht nuk do të ketë më asnjë dilemë, ndaj për këtë kam vendosur të luaj me 4 faktorë: faktorin ndërinstitucional, ku do të ndërtoj marrëdhënie të shkëlqyera me të gjitha institucionet, qoftë vertikalisht nga Presidenti, te Kuvendi dhe institucionet tjera, qoftë edhe horizontalisht me të gjithë aktorët që do të ndërlidhen në punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Sigurisht, më e rëndësishmja është puna me cilësinë e duhur për organizimin e procesit zgjedhor, qoftë me komisionet zgjedhore, qoftë me grupet e numërimit apo me çdo proces tjetër. Gjithashtu, do t'i kushtoj rëndësi jashtëzakonisht të madhe faktorit të teknologjisë, përderisa komisioni, politika, parlamenti i kushtojnë rëndësi jashtëzakonisht të madhe dixhitalizimit, numërimit elektronik të votave. Pra, edhe ky është një element tjetër që do të insistoj në këtë drejtim.

Së fundi, është infrastruktura për procesin zgjedhor, për të cilin do të punoj në këtë komision, që të mos mungojë absolutisht asgjë, që nga momenti kur komisioni do ta fillojë

këtë proces deri në ditën e votimi. Ajo që është më e rëndësishmja është faktori kulturor, ku duhet të punojmë të gjithë me vlerat tona, në mënyrë që një herë e përgjithmonë, pas 30 vjetësh, në Shqipëri të mos diskutohet më nëse ishte vendim i drejtë apo nuk ishte vendim i drejtë, votat u numëruan keq apo u numëruam mirë. Këtë angazhim, nëse unë do të jem pjesë e këtij ekipi, besoj se qytetarët shqiptarë nuk do ta dëgjojnë më pas datës 25 prill.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Vazhdojmë me kandidatin për KAS-in, zotin Agron Sulshabani.

Zoti Agron, ju lutem, një prezantim shumë të shkurtër për veten dhe pse kërkonti të aplikoni për KAS-in, si dhe eksperiencat tuaja. Çdo kandidat duhet të ketë parasysh se koha totale është 5 minuta, por mund ta përmbledhni prezantimin tuaj shkurt vetëm në dy minuta, në mënyrë që të kemi mundësi t'ju bëjmë ndonjë pyetje, gjithmonë nëse do të ketë pyetje.

**Agron Sulshabani** – Unë quhem Agron Sulshabani dhe jam i diplomuar për drejtësi në vitin 1994 në Fakultetin e Drejtësisë, si fakultet të dytë. Karrierën time e kam filluar si hetues në Laç. Kam eksperiencë në policinë shtetërore në pushtetin lokal, si drejtues i departamentit pranë kësaj bashkie. Në karrierën time kam drejtuar edhe disa komisariate në disa rrethe në periudhën 2005-2013, por para kësaj periudhe dhe pas kësaj periudhe kam punuar si avokat pranë Dhomës së Avokatisë Lezhë. Aktualisht ushtroj edhe profesionin e avokatit pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë.

Ideja që unë jam sot para jush është se gjatë karrierës sime, edhe kur kam qenë avokat në profesion të lirë, jam marrë me proceset zgjedhore. Në vitin 2000 kam qenë drejtues i KZQV-së në Mamurras dhe në vitin 2005 kam qenë zëvendëskryetar i KZZ-së nr. 16. Jam trajnuar dhe kam qenë trajner i komisionerëve lokalë të të gjitha nivele nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, OSBE-ja, Prokuroria e Përgjithshme dhe USAID-i. Gjithashtu, edhe kur kam qenë në cilësinë e shefit të komisarariatit për detyra specifike që ka Policia e Shtetit në marrëdhënie me procesin zgjedhor. Jam trajnuar nga zyra e Prokurorit të Përgjithshëm dhe OSBE-ja. Jam trajnuar për trajner dhe kam trajnuar në drejtoritë e qarqeve respektive të gjithë rolin bazë dhe rolin e mesëm të Policisë së Shtetit.

Në të gjithë karrierën time si drejtues komisaratesh nuk kam pasur asnjë incident me zgjedhjet, përkundrazi, kam pasur sukses. Edhe kur kam qenë drejtues i KZQV-së në Mamurras në vitin 2000, por edhe i KZZ-së 16 në vitin 2005, jam përpjekur të menaxhoj dhe në të gjitha rastet vendimet kanë qenë 7 me 0, nuk kemi pasur asnjë problem, as në KQZ dhe as në Kolegj Zgjedhor.

**Damian Gjikhuri** – Nga dokumentacioni që u verifikua nga administrata, ju nuk keni plotësuar një deklaratë për sa i përket papajtueshmërisë, një nga kushtet që mund të çojë në konflikt interesi, siç mund të jetë, për shembull, anëtarësia në një parti politike.

A jeni anëtar në ndonjë parti politike?

**Agron Sulshabani** – Jo.

**Damian Gjikhuri** – Nuk jeni anëtar?

**Agron Sulshabani** – Jo.

**Damian Gjikhuri** – Pse nuk e keni plotësuar deklaratën?

**Agron Sulshabani** – Jam përpjekur të jem korrekt me kërkesat që ka Kuvendi, megjithatë është plotësisht e verifikueshme.

Unë jam aq koshient, sa të mos vij para jush politikisht.

**Damian Gjikhuri** - Dakord, por nga ana formale duhet plotësuar.

**Agron Sulshabani** – Dakord, nga ana formale, mund ta plotësoj menjëherë. Por nuk jam i përfshirë.

**Damian Gjikhuri** – Duhet të jetë si dokumentacion.

**Agron Sulshabani** – Realisht, jam përpjekur të jem korrekt, megjithatë ...

**Damian Gjikhuri** – Ne e kemi konstatuar këtë, por po them se mund ta korrigjojmë.

**Agron Sulshabani** – Patjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – Paska konflikt interesi.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zotëria tha: “Nuk jam anëtar partie”.

**Agron Sulshabani** – Jo, ne, nëse ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – Thuaj të vërtetën, ke qenë apo jo?

**Agron Sulshabani** – Nëse do të më lejoni të mbështes zotin Murrizi, ne kemi krijuar Partinë Demokratike në atë kohë, me shumë pasion, dhe nga viti 2005, kur unë u rekrutova në Policinë e Shtetit, nuk jam përfshirë më dhe do të përpiqem që në të ardhmen e karrierës sime të jap një ide jo më politike policore, por diçka më konstitucionale. Unë i kam parasysh ndalesat që janë nëse do të jem anëtar i KAS-it nesër në ekzekutiv, jam koshient.

**Oerd Bylykbashi** – Duke qenë se ne vendosëm t’i verifikojmë këto raste në mbledhje komisioni, unë besoj se është i mjaftueshëm vetëdeklarimi publik që bën kandidati. Ky është rasti i parë, i tillë dhe të mbahet shënim nga sekretaria. Besoj se do të jetë e tepërt të plotësohet formular thjesht për një vetëdeklarim që bëhet publikisht para nesh.

**Alket Hyseni** – Duhet të jetë në dosje, sepse është një nga kriteret e dokumentacionit.

**Agron Sulshabani** – Edhe një herë, nëse më vë administrata ...

**Alket Hyseni** – Me gjithë respektin për zotërinë, dhe jo vetëm për këtë rast, do të na mjaftonte, proceduralisht, mangësia e kësaj, që ne të mos e kishim thirrur sot, por ne ramë dakord që do t'i thërrisnim të gjithë. 5 minuta punë është, plotësoje, që të mos përbëjë shkak për ...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Formularin që ke, e tërheq aty dhe e plotëson.

**Adnor Shamati** – Përshëndetje!

Në mos gaboj, keni ardhur edhe herë tjetër? Kryesoni një shoqatë të avokatëve, apo e kam gabim?

**Agron Sulshabani** - Jo, më ngatërroi.

**Adnor Shamati** – Keni ardhur në ndonjë takim tjetër?

**Agron Sulshabani** – Është hera e dytë që vij në Kuvendin e Shqipërisë, atë ditë që kam aplikuar në protokoll, dhe sot.

**Adnor Shamati** – Dakord.

Nga Shoqata e Avokatëve Penalistë, apo diçka e tillë?

**Agron Sulshabani** – Jo, jam pjesë, por jo në nivele për të marr diçka përsipër.

**Damian Gjijnuri** – Zoti Arben Isaraj, aplikant për pozicionin e Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve.

Zoti Isaraj, mirë se erdhët!

Shumë shkurt, pse keni aplikuar për këtë pozicion? Diçka për veten tuaj, nisur nga kriteret që përcakton ligji për eksperiencën tuaj, sidomos në shqyrtime administrative dhe si e mendoni pozicionin delikat dhe të rëndësishëm, nisur edhe nga ushtrimi juaj i detyrës në të kaluarën, por edhe në atë që do të jepni në këtë institucion. Kohën e kemi të kufizuar, dhe mundësisht, 2-3 minuta të bëni një prezantim të shkurtër për t'u lënë mundësi pyetjeve.

Faleminderit!

**Arben Isaraj** – Jam i qartë për pjesën e ngarkesës.

Pak a shumë, gjërat janë të shkruara. I keni të gjitha përpara dhe nuk kam pse të zgjatem shumë.

E rëndësishme është që jam jurist në profesion. Sot ushtroj detyrën e pedagogut të brendshëm në Shkollën e Magjistraturës dhe me këtë rast, ne njerëzit, sigurisht, jemi si librat. Të gjithë na gjykojnë nga kopertinat, por këtu nuk duhet të ndodhë kjo gjë, dhe, sigurisht, nuk ndodh derisa po pyetemi për ato që kemi bërë në jetë.

Eksperienca ime për zbatimin e ligjit, dhe sigurisht, kjo e drejtë administrative nuk përjashtohet, lidhet me karrierën time 32-vjeçare, nisur kjo me të gjitha funksionet dhe detyrat që kam ushtruar. Jam ndeshur herë pas here jo vetëm me ligjbërje, kur flasim për procesin e hartimit dhe të miratimit në Ministrinë e Drejtësisë, në Kuvend, por edhe te pjesa e ekzekutimit, e hetimit administrativ, por edhe e pjesëmarrjes në gjykime, qoftë si avokat, por edhe si drejtues, duke filluar nga zëvendësdekan i Fakultetit të Drejtësisë, por edhe në hartimin e akteve administrative që hyjnë me rregullore, rregullat e brendshme, marrja e vendimeve, që unë i drejtoja në bazë të strukturës që më ishte ngarkuar, pjesa mësimore, si dhe në pjesën kur kam qenë drejtues së fundi, kur me fuqinë që më jepte ligji, statuti e të tjera, kisha mundësinë të hartoja që nga ato të famshmet statutet e rregullimit, rregulloret e brendshme dhe pastaj ndjekjen e procedurave që lidhen më shumë me marrëdhëniet e punës, por që hyjnë te pjesa administrative nga fillimi dhe deri në fund, domethënë ndiqja hap pas hapi trajtimin dhe gjykimin në administratë.

Sigurisht, ajo që dua t'ju them në mënyrë sa më të shkurtër, dhe mbaron kjo punë, është që në këtë botë njeriu është i lirë ta zgjedhë skllavërinë e tij dhe unë gjatë gjithë kohës, për 32 vjet kam qenë skllav vetëm i ligjit dhe në të gjitha funksionet dhe detyrat që kam ushtruar nuk ka ndodhur kurrë që të kem marrë qoftë një vërejtje, të kem pasur ndonjë ankesë apo të kem pasur edhe një masë.

Jam i bindur se një rol të rëndësishëm për zgjedhje të suksesshme ka edhe konsolidimi i shtetit të së drejtës, ku menaxhimi i zgjedhjeve organizohet në bazë të rregullave strikte dhe ndëshkimi i atyre që i manipulojnë zgjedhjet duhet të jetë i pakompromis. Përmes këtyre standardeve, pas Luftës së Dytë Botërore, kanë ecur të gjitha vendet e përpara që ne po i marrim si shembull Britania, Gjermania, Franca, SHBA-ja dhe të shumë të tjera.

Sot, ne jetojmë në teatrin e përbashkët, të cilin do ta quaja “teatri i jetës”, ku të gjitha, edhe menaxhimi i zgjedhjeve, edhe rasti i debateve për reformën zgjedhore nuk bëjnë përjashtim dhe nëse në këtë teatër ne do të qëndrojmë spektatorë, sigurisht do të paguajmë për veten, për fëmijët dhe për të ardhmen e vendit.

Prandaj gjykova, pasi pashë se i plotësoja të gjitha kriteret që ishin të përcaktuara nga ligji, se është koha për të mos qëndruar më si spektator dhe aplikova për të qenë anëtar i kastit në KQZ.

Faleminderit!

Nëse keni ndonjë pyetje.

**Damian Gjiknuri** – A ka ndonjë pyetje?

Po, zoti Murrizi.



**Myslim Murrizi** – Më vjen mirë që keni aplikuar, nëse shpirtërisht ndihesh i pavarur për hatër të funksioneve që ke pasur, ke qenë deputet siç jam edhe unë, siç kanë qenë edhe këta të dy, besoj se do t'i bëjë mirë organit ku do të shkosh, duke shpresuar në performancën dhe integritetin tënd si profesor dhe si individ. Ti e ke ndarë vetë shkëputjen shpirtërore, se ajo është gjë shpirtërore, nuk ndahet me thikë, as me letër dhe as me deklaratë, siç i tha Damiani një mikut tim para jush: “Sill një deklaratë që nuk je anëtar partie”. Për mua është kënaqësi që një kapacitet i tillë dhe një njeri me *background*-in tuaj vjen dhe ofrohet për të kontribuar me aq sa mundet që më 25 prill të mos kemi më duar në zgjedhje.

**Damian Gjikhuri** – Arbeni e ka plotësuar deklaratën, kështu që kjo është thjesht mungesë vëmendjeje.

Nëse nuk ka pyetje të tjera për ju, ju uroj natën e mirë!

Vazhdojmë me kandidatin e radhës, i cili ka aplikuar për komisioner dhe rregullator.

Mirëmbërëma, zoti Xhiku!

Siç edhe jeni njoftuar, komisioni po e zhvillon këtë seancë dëgjimore, prandaj do të doja për 2-3 minuta thjesht një prezantim se çfarë ju motivoi që të kandidoni për këto dy pozicione dhe të na flisni pak për eksperiencën tuaj dhe se çfarë do të bëni në një nga këto organe nëse zgjidheni. Më pas mund të ketë nevojë për ndonjë pyetje.

**Arben Xhiku** – Faleminderit!

Në radhë të parë dua t'ju falënderoj që më dhatë mundësinë për të më dëgjuar në këtë garim që po bëj.

Unë quhem Arben Skënder Xhiku, i martuar, me dy fëmijë, lindur dhe rritur në Tiranë dhe banues në Tiranë. Eksperienca ime e punës fokusohet në 3 drejtime kryesore: në aspektin teknik, në aspektin e menaxhimit dhe të administrimit dhe në atë funksioneve akademike nga, e cila nuk jam ndarë deri tani.

Motivimi ishte, sa i takon pyetjes së parë që thatë ju, duke parë eksperiencën e punës dhe eksperiencën që kam kaluar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si anëtar i këtij komisioni në vite jo të lehta, 1996-1998, mendova të jepja kontributin tim në këtë institucion për ta futur në një stad të ri, ashtu siç e ka edhe ligji, për ta çuar në shinat e menaxhimit më tepër sesa të asaj politike, ku bëhen debate politike. Ky është pikësynimi im dhe bindja ime, pastaj se si rrjedhin gjërat e tjera në aspektin e zgjedhjes ose jo i përket Kuvendit.

Unë kam një eksperiencë jo të pakët në punë falë edhe moshës që kam. Kam punuar shumë në administratën shtetërore, nuk i jam ndarë administratës shtetërore, pavarësisht këtyre viteve të fundit, kur kam qëndruar gjysmë pushim. Kam qenë gjithmonë i suksesshëm

në punën time, për këtë flasin edhe rezultatet që kam arritur në ato institucione që kam drejtuar.

Sa u përket zgjedhjeve, i njoh mirë, sepse në ato vite, siç jua thashë pak më lart, kam qenë anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kanë qenë vite të vështira, vite që Komisioni Qendror nuk i kishte ato resurse dhe atë administratë që ka sot.

I jam drejtuar Kuvendit me një kërkesë për 3 poste, atë të komisionerit, të nënkomisionerit dhe të Komisionit Rregullator për faktin se pashë që të gjitha kërkesat, të cilat ishin parashtruar nga ana e Kuvendit, ishin kërkesa që unë i plotësoja dhe kam bindjen që mund t'i plotësoj shumë mirë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ka edhe brenda administratës, kam qenë vartësi juaj.

**Damian Gjiknuri**- Unë të njoh herët, kam konsideratë për ty, por jeta kështu është, edhe ne kemi lëvizur nga pozicioni që kishim, kështu që, prandaj është e bukur jeta, sepse të krijon mundësi dhe horizonte të reja.

Unë zotin Xhiku e njoh që në vitin 1994, në mos gaboj.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Nuk është avantazh të kesh lindur para kohe.

**Oerd Bylykbashi** - Zoti Xhiku ka kërkuar edhe për nënkomisioner.

**Damian Gjiknuri** - Po, nuk është vënë këtu.

**Arben Xhiku** – Unë kam aplikuar për komisioner, nënkomisioner dhe rregullator, për në KAS nuk i plotësoj kriteret.

**Damian Gjiknuri** – Faleminderit!

Zoti Myslimaj e ka lënë për nesër.

Arenc Çela, ju lutem, na bëni një prezantim të shkurtër për veten. Çfarë të shtyu të kandidosh?

**Arenc Çela** – Jam Arenc Çela, kam studiuar në Itali për drejtësi, në Universitetin e Bolonjës. Kam pasur një eksperiencë trevjeçare si asistent pedagog në Itali, në universitetin ku u diplomova, më pas erdha në Shqipëri dhe prej 3 vjetësh punoj këshilltar në Grupin Parlamentar të PS-së. Unë kandidova sepse shpresoja të sjell një frymë të re perëndimore në reformën e re që po behët për KQZ-në. Nuk kam konflikt interesi, nuk jam anëtar partie.

**Damian Gjiknuri** – A keni ndonjë pyetje për kandidatin.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Arenc Çela** - Po, mbi 3 vjet e gjysmë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po.

**Damian Gjijnuri** – A keni eksperiencë në gjykime administrative, që keni aplikuar për KAS-in?

**Arens Çela** – Jo.

**Damian Gjijnuri** - Pra, nuk keni eksperiencë në gjykime administrative, mbani shënim, se nuk klasifikohet për KAS.

Natën e mirë.

Kandidati tjetër?

Mirëmbërëma Behar!

Ju keni aplikuar për pozicionin e rregullatorit?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Rregullator dhe KAS.

Atëherë, zoti Zeneli, çfarë ju shtyu të kandidoni për këtë pozicion? Pse vlen eksperiencia juaj e kaluar për Komisionin Rregullator dhe për Komisionin e Ankesave? Komisioni Rregullator ka të bëjë më shumë me aktet e rregullit të shkruarit në politikëbërjen e institucionit, ndërsa ankimori dhe sanksionet kanë të bëjnë me eksperiencën tende në gjykimet administrative. Shumë shkurt përqendrohuni te karriera juaj. Keni një mangësi në formularin e deklaramit të konfliktit të interesit, pra, a jeni anëtar i ndonjë partie ose jo, që duhet plotësuar, dhe i takon komisionit ta gjykojë pastaj.

**Behar Zeneli** – Mirëmbërëma!

I nderuar kryetar i komisionit,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Nisur nga njoftimi që është bërë nga Kuvendi në lidhje me pozicionet e anëtarëve të Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Apelimit, mendova se i plotësoj të gjitha kërkesat me kualifikimet që kam. E gjithë jeta ime juridike është e ndërtuar mbi bazën ligjore, pra kam prekur që nga ndërtimi ligjin e prokurimit, ligjin për falimentimin, ligjin e Kodit Civil, ligjin për pushtetin lokal, ku unë aderoj sot dhe jam sekretar i këshillit të Bashkisë së Tiranës. Pra, unë bëj pjesë të pjesa e juristëve dhe e kam me pasion që të jap gjithçka për atë që jam formuar në lidhje me Komisionin Rregullator ose me Komisionin e Apelimit, nëse nga komisioni do të jem kandidatura e përzgjedhur.

Besoj se gjithçka do të mbështetet te parimi i barazisë para ligjit, te parimet e respektimit të gjithçkaje që thotë Kushtetuta, dhe të gjitha aktet ligjore e nënligjore. Pra,

kontributi im do të jetë maksimal në marrjen vesh të të gjithë komisionit, i cili do të jetë një komision i përzgjedhur nga ju si për Rregullatorin ose Komisionin e Administrimit të Ankesave. Kështu, do të jem pjesë e një ekipi, nëse do të zgjidhem, do të jem bashkëpunues dhe do të jap kontributin tim për gjithçka për këtë vend dhe për të ecur në të ardhmen.

Besoj se formimi është i shumë mjaftueshëm në lidhje me atë që jam. Kjo është pjesa ime kryesore.

**Damian Gjikhuri** – Unë ju njoh prej vitesh, se normal jemi vend i vogël, por dua t'ju bëj një pyetje për të sqaruar edhe publikun, sepse shoh pozicionin që keni, përveç pjesës rregullatore, që thatë për eksperiencën tuaj, te çështja e Komisionit të Ankimeve, duhet një eksperiencë 3-vjeçare në shqyrtime të konflikteve administrative. Mund ta specifikoni eksperiencën tuaj në lidhje me të?

**Behar Zeneli** – Po e paralelizoj me fushën e prokurimit publik, që kam ndjekur: parlamenti shqiptar vendos disa rregulla, KQZ-ja zbaton ose vendos disa rregulla për aktorët në konkurrim. Pra, po bëj një paralelizim me termat e dokumenteve të tenderit të një institucioni me garën që do të vijë nga jashtë, që janë ofertuesit ose partitë politike, për mua është pak a shumë kështu. Kërkesat, interpretimet, ankesat apo edhe përgatitja e legjislacionit të sotëm është përgatitur që në kohën që unë kam qenë drejtor i Prokurimeve dhe kam dhënë një kontribut të veçantë edhe te ligji për pushtetin lokal, edhe për fushën e legalizimeve, si zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Legalizimeve të Republikës së Shqipërisë. Pra, eksperiencia ime në fushën legjislative them se është një eksperiencë që do t'u shërbejë të dyja komisioneve, si Apelimit, ashtu edhe Rregullatorit.

Nëse do të zgjidhesha, do të jetë një privilegj dhe nder edhe për komisionet që të zgjidhen njerëz me eksperiencë të karakterit që kam unë.

**Damian Gjikhuri** – Agjencia e Prokurimeve Publike, që ju keni drejtuar, ka pasur kompetencë edhe shqyrtimin e ankesave administrative në kohën kur ti e drejtoje këtë institucion. Po apo jo?

**Behar Zeneli** – Në kohën kur kam qenë drejtor i kësaj Agjencie, ka qenë institucioni i vetëm në Republikën e Shqipërisë që merrej me interpretime, me kërkesa, me miratime dhe me procesin e ankimimit. Ankimimi është e njëjta procedurë si në KQZ, ku partitë garojnë dhe bëjnë ankesa, edhe ofertuesit bënë garë. Është i njëjti parim, po i bëj një paralelizëm (edhe zoti Oerd është jurist dhe është marrë me këtë punë), ka një paralelizëm të tillë si “ofertues për ofertues”, pra partitë janë kandidatë. Edhe në konkurrim fondet publike ishin kandidatët, ofertuesit, dhe unë i fus si paralele, përveç eksperiencave të tjera kuptohet, që

edhe gjatë kohës së legalizimit, shqyrtimi i ankesave, shqyrtimi i kërkesave nga qytetarët, e njëjta gjë është, procedurë administrative.

Edhe te pjesa e ligjit, drejtori i Përgjithshëm i Burimeve Natyrore në Ministrinë e Ekonomisë, gjithë burimet natyrore: energji, hidrokarbure, minierat, të cilat ishin edhe licencime apo edhe apelime, apo ankimime nga firmat, është e njëjta procedurë, pra ka të bëjë me legjislacionin.

Formimi im në kuadër të gjithë eksperiencës që kam...

*(Diskutim pa mikrofon)*

**Damian Gjikhuri** – Fjala për zotin Besnik Maho.

Radhën e kishte zoti Agim Paskali, por për shkak të vonesës, u fut zotëria. Ka qenë i dyti në radhë, në mos gaboj.

Zoti Maho, ju lutem, shumë shkurt, bëni një prezantim prej dy minutash për veten: pse keni aplikuar në një nga këto dy organe dhe si e mendoni veten tuaj në këto dy pozicione, nëse zgjidheni?

**Besnik Maho** – Kam filluar punë për herë të parë në Ministrinë e Financave në vitin 1996 dhe jam shkëputur prej saj në vitin 2017. Gjatë këtyre viteve kam bërë punë të ndryshme në këtë ministri, duke filluar nga niveli i ulët si specialist, përgjegjës, drejtor drejtorie, kryetar i Degës së Thesarit të Tiranës dhe në vitin 2017 jam shkëputur. Aktualisht punoj te Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Komisioni i Vetingut, si drejtor Ekonomik.

Paraprakisht doja të thosha se kam mbaruar dy fakultete, atë Ekonomik dhe Juridik, megjithëse gjatë gjithë kohës kam punuar si ekonomist. Kam aplikuar për Komisionin Rregullator dhe të KAS-it për të dhënë kontributin tim, sigurisht në rast zgjedhjeje, pasi për shumë kohë kam punuar si menaxher në institucione dhe drejtori të ndryshme dhe mendoj se procesi elektoral nuk është gjë tjetër veçse një proces, i cili duhet menaxhuar në bazë të ligjit dhe Kodit Zgjedhor që do të jetë në fuqi.

Për sa u përket aftësive të mia në menaxhim, besoj se kam kontribuar goxha në aparatet kur kam punuar në Ministrinë e Financave dhe së bashku me njohuritë juridike që kam mendoj që në Komisionin Rregullator mund ta menaxhoj mirë këtë punë.

Gjatë gjithë periudhave që kemi punuar, në fund të fundit, kemi zbatuar ligje të llojeve të ndryshme dhe në këtë rast mendoj se thjesht do të duhet të zbatojmë ligjet.

**Damian Gjikhuri** – Prezantimi është i saktë, përveç faktit që duhet të paraqisni një formular të konfliktit të interesit, që në mos gaboj, nuk e keni paraqitur...

**Besnik Maho** – E kam paraqitur.

**Damian Gjikhuri** – Kështu më rezulton nga stafi këtu. Megjithatë, sqaroni mosekzistencën e formularëve.

**Agim Paskali** – Ato dy formularët kam plotësuar, që kanë qenë te faqja e Kuvendit.

**Damian Gjikhuri** – Kam një pyetje, se eksperiencia juaj është më shumë financiare. Ky është një organ i karakterit qoftë Rregullatori, që ka të bëjë me rregullin në të shkruar dhe përgjithësisht eksperiencë në hartimin e legjislacionit, qoftë ajo që keni aplikuar në Komisionin Ankimor, që do më shumë eksperiencë të karakterit juridik në shqyrtime administrative, pra më shumë të karakterit gjykues dhe aftësi të tjera të këtij lloji, prandaj them si e shikoni veten, se eksperiencia juaj është më shumë e karakterit financiar.

**Agim Paskali** – Është e karakterit financiar, por unë e parashtrova që gjatë gjithë kohës kam bërë punë menaxheriale. Mendoj se në fund të fundit, thjesht do të zbatohet një ligj. Ligji është Kodi Zgjedhor, që do të miratohet, Kushtetuta dhe ligjet anekse, që mund të jenë ndihmëse. Gjatë gjithë periudhës që kam punuar, kam zbatuar shumë lloj ligjesh si ligji i menaxhimit financiar, ligji i buxhetit, ligji i inspektimit financiar, i auditimit, kontabilitetit dhe në fund të fundit, unë e shoh këtë thjesht si një proces që fillon, vazhdon dhe mbaron, ka lëndën e parë, vazhdon nëpërmjet ligjit, nxjerr produktin, shpall deputetët përfundimtar të Kuvendit. Besoj se nga ana juridike nuk është ndonjë problem, sepse gjatë 25 vjetëve të punës sime unë vetëm ligje kam zbatuar. Përvojën juridike e kam pasur në bërjen e disa ligjeve, pra kam marrë pjesë te ligji “Për auditimin e brendshëm”, ligjin e inspektimit financiar, kështu që personalisht nuk e shoh ndonjë gjë të vështirë.

Faleminderit!

Mirupafshim!

**Damian Gjikhuri** – Kandidati i radhës është Besnik Maho, Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo jo, ky qe Agim Paskali.

Mirëmbërëma, Besnik!

Shumë shkurt një prezantim të personit tuaj, pse keni kërkuar të aplikoni në Komisionin e Ankesave të KQZ-së, pra pse eksperiencia, profili dhe virtytet tuaja do t’i vlejnjë këtij pozicioni, gjë që ju ka shtyrë për të aplikuar?

**Besnik Maho** – Duke ju falënderuar për mundësinë që më keni dhënë mua dhe të gjithë kandidatëve të tjerë për t’i shërbyer një procesi kaq delikat dhe të rëndësishëm, që i takon vendit, pashë gatishmërinë time sociale dhe juridike për të dhënë kontributin,

pavarësisht garës, për të ofruar kandidaturën time në pozicionin e KAS-it, Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve.

Arsyeja kryesore ka të bëjë me *background*-in tim profesional.

Kam mbaruar Fakultetin e Drejtësisë, Shkollën e Magjistraturës, kam ushtruar detyrën e gjyqtarit për më shumë se 3 vjet, kam dhënë dorëheqjen me vendim të KLD-së dhe jam komanduar në pozicionin e drejtorit të Përgjithshëm, që ishte një organ *quasi* gjyqësor. Gjatë të gjithë veprimtarisë sime si gjyqtar, sepse kam ruajtur të njëjtin status, më është dashur të përballim me çështje të ndryshme të karakterit civil dhe administrativ, si dhe procese zgjedhore.

Përvoja ime fillon më herët se kaq, sepse është çështje kushtetuese, është çështje e të drejtave dhe e parimeve themelore mbi të cilat ndërtohet shteti i së drejtës në demokraci. Më është dashur të jem pjesë e komisioneve zonale në Qytetin Studenti, ku kam dhënë kontributin tim personal si anëtar, më është dashur të jem përfaqësues i një kandidati në një qendër votimi në komunën Dajt, më është dashur të jem jurist dhe kam shërbyer me shumë devotshmëri në zgjedhjet lokale të vitit 2003.

Më pas përvoja ime ka devijuar në proceset akademike, ku kam 15 vjet që jap ekspertizën time si akademik, si pedagog në fushën e të drejtës private dhe administrative në dhjetëra botime brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu, kam shërbyer edhe si këshilltar pranë Ministrisë së Drejtësisë në kuadrin e programit “*Lead Albania 2018-2019*” me fondacion amerikan AADH.

Them që kam një përvojë të konsiderueshme për t’u përballur me këtë proces, që e shoh si një sfidë, jo si një privilegj, pasi vendimmarrjet që kam dhënë si gjyqtar, opinionet që kam dhënë në formën e shkrimeve akademike, vendimmarrjet që kam dhënë në Institucionin e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronës si drejtor i Përgjithshëm, më bëjnë sot të kuptoj se jam i gatshëm të përballim si një nga anëtarët e këtij institucioni, që do të krijohet më pas në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky është në vija të përgjithshme *background*-i im profesional.

Sikurse e theksova edhe në vijim shpreh angazhimin tim social dhe personal për t’i shërbyer këtij procesi kaq të rëndësishëm.

**Damian Gjikhuri** – Mirë, natën e mirë dhe faleminderit!

**Besnik Maho** – Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Mirëmbërëma, zoti Skënderi!

Ju keni aplikuar për pozicionin e komisionerit, tashmë jeni person publik dhe të gjithë ju njohin si anëtar i KQZ-së, pra keni eksperiencë në zgjedhje. Një pyetje kam unë para se të filloni me prezantimin.

Ju, kur keni aplikuar a keni dhënë dorëheqjen nga KQZ-ja?

**Bledar Skënderi** – Jo, jam anëtar në detyrë.

**Damian Gjiknuri** – Dakord. Mund të bëni një prezantim të shkurtër.

**Bledar Skënderi** – Unë quhem Bledar Skënderi, kam lindur në 12 gusht 1978 në Frashër të Përmetit. Kam mbaruar Fakultetin e Drejtësisë në vitin 2001. Gjatë këtyre 20 vjetëve kam kryer detyra të ndryshme, përgjithësisht detyra shtetërore, kam qenë zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve, zëvendës drejtor i Përgjithshëm i ALUIZMI-t, kam marrë një mandat plotësues si anëtar i KQZ-së dhe në nëntor të vitit 2018 kam marrë një mandat 6-vjeçar, i cili po ndërpritet për shkak të reformës zgjedhore parimisht, meqë po kandidoj për komisioner, besoj se ju do të jeni kuriozë për të ditur se çfarë platforme, çfarë ideje kam unë për funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por që të them se çfarë ideje dhe platforme kam për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, fillimisht do të doja të bëja shkurtimisht një analizë të punës që kam bërë, për t'i shpejguar edhe publikut ndoshta edhe kushtet.

Trupa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, edhe kështu siç... Faktikisht, edhe une e kam lexuar ligjin dhe aty thuhet “ish, ish, ish”, por ndërkohë unë kam qenë funksionar, jam aktualisht në detyrë si anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, hapa edhe Fjalorin e Shqipes së Sotme, ku thuhet se “ish” është një pasthirmë që përdoret për të trembur pulat. Nuk e di nëse “ish” është përdorur në këtë lloj konteksti në ligjin zgjedhor, jam dakord.

**Damian Gjiknuri** – Bledi, faleminderit!

Natën e mirë!

Zonja Avdyli, shumë shkurt, ju keni aplikuar për komisionere dhe për komisionin rregullator. Na tregoni pak nga eksperiencia juaj se përse përshtateni në këto dy pozicione dhe çfarë ju shtyu të kandidoni për to.

**Drita Avdyli** – Faleminderit!

Unë jam Drita Ferri Avdyli. Jam nga Durrësi. Kam studiuar në Fakultetin e Ekonomisë në vitin '86 dhe Fakultetin e Drejtësisë. Kam mbrojtur doktoraturën me temën e emigracionit. Këhstu që një ndër hapat e aplikimit ishte, meqenëse do të votojnë edhe emigrantët, e pashë edhe veten këtu, duke qenë se kam një eksperiencë të gjatë në menaxhim, mendova të aplikoj. Gjatë viteve 2006-2013, kam qenë kordinatore e MARR-it dhe duke qenë se kam qenë pjesë e grupit të punës për strategjinë e emigracionit, 2005 – 2010, duke



qenë se e drejta e të gjithë emigrantëve që jetojnë jashtë, përveçse kanë kosto për të votuar, për të ushtruar të drejtën e tyre, ato kanë të drejtën ose shteti duhet t'u garantojë atyre edhe aty kiu jetojnë. Meqenëse kjo ishte pjesë e strategjisë dhe nga ana financiare nuk e bë asgjë për ta zbatuar, e pashë te ndryshimet ligjore që ëhstë bërë pjesë e ligjit të ri dhe doja të aplikoj.

Gjithashtu, aplikova edhe për vendin tjetër, meqenëse ëhstë një komision, i cili merret me rregullimet e akteve normative, meqenëse kam qenë pjesë e grupit e punës, duke filluar që në '99 me ligjin e statusit të nëpunësit civil, me ligjin për azilin, ligjin për integrimin e refugjatëve, te paketa ligjore e reformës në drejtësi kam qenë pjesë e grupit të shumë grupeve për ndryshimet ligjore.

**Damian Gjikhuri** – A ka ndonjë pyetje?

Faleminderit, zonja Avdyli!

Natën e mirë!

**Drita Avdyli** – Faleminderit ju!

**Damian Gjikhuri** – Dritan Çaka, komisioner, rregullator dhe komisioni i Ankimeve, pra për të tria pozicionet.

Zoti Çakaj na tregoni shumë shkurt eksperiencën tuaj me zgjedhjet dhe çfarë ju shtyu të kandidoni për një nga pozicionet, pra pse ju mendoni që keni eksperiencë qoftë për komisioner, qoftë për komisionin ankimor dhe për atë rregullator, pra pak a shumë, *background*-in tuaj në 2-3 minuta, civile apo administrative, ato që kanë këtë kompetencë.

**Dritan Çakaj** – Për sa i përket fushës së zgjedhjeve, edhe në periudhën që kam qenë avokat, kam pasur përfaqësime ligjore edhe pranë KQZ-së si përfaqësues i subjekteve të ndryshme politike, edhe në Kolegjin Zgjedhor, ndërsa tani së fundi kam qenë edhe ekspert i jashtëm i komisionit të posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore, derisa mbaroi mandati më 30 qershor 2020.

**Damian Gjikhuri** - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Elona Bano, që ka aplikuar për komision rregullator!

Shumë shkurt na tregoni se çfarë eksperience keni, që ju ka shtyrë të aplikoni në këtë komision rregullator dhe një prezantim të shkurtër për veten.

**Elona Bano** – Përshëndetje!

Jam doktore e shkencave në të drejtën administrative. Kam një eksperiencë të gjerë në pjesën e draftimit, të oponencës ligjore dhe të përgatitjes së draft-ligjeve dhe akteve të ndryshme normative, të cilat kanë filluar që në vitin 2012 si pjesë e një komisioni për

mbikëqyrjen e strategjisë ndërsektorale të drejtësisë, ku personalisht kam qenë përgjegjëse për objektivin 5, që ishte ekzekutimi i vendimeve civile dhe atyre penale.

Duke filluar nga viti 2013 kam qenë pjesë e të parës klasë White Albania, që është një model i White House Fellowship i implementuar nga shefi i fondacionit shqiptaro-amerikan për zhvillim, ku u përzgjedha këshilltare e Presidentit të Republikës për 1 vit e gjysmë dhe kam pasur shansin të ndjek dhe të analizoj aktet ligjore, sidomos projektdekrete, të cilat përgatiteshin për Presidentin, duke u fokusuar në dy momente të rëndësishme të kohës, ligjin “Për nëpunësin civil” dhe ligjin “Për autoritetet dhe pushtetet e forcave të NATO-s”.

Në vitin 2015 ka vijuar më me intensitet aktiviteti im në pjesën e oponencës dhe draftimit të akteve ligjore, duke qenë pjesë e sekretariatit teknik të reformës në drejtësi pranë komisionit të posaçëm parlamentar, e fokusuar dhe e ndarë në dy grupe:

1. Grupi për profesionet e lira
2. Grupi për financimin e sistemit të drejtësisë dhe statusit të magjistratëve, prokurorë dhe gjyqtarë

Kjo reformë është duke u implementuar, sidomos pjesa e profesioneve dhe e kuadrit ligjor të tyre dhe po vazhdon edhe sot e kësaj dite dhe së fundi është edhe profesioni i ndërmjetësve, arbitrave dhe i përkthyesve ligjorë, si paketë e përgatitur që në atë kohë.

Gjithsesi, pika kulminante, e cila më bën më me vizion dhe është arsye pse kam konkuruar për të qenë pjesë e komisionit rregullator, fillon në fund të vitit 2018, ku kam filluar eksperiencën si drejtoreshë e kabinetit të ministrit të Shtetit për Diasporën. Pata fatin e madh që të njoh dhe të shoh si funksionon diaspora shqiptare dhe një nga arritje për të cilën ju përgëzoj ju, por edhe gjithçka që është arritur, është mundësimi i heqjes së pikës “d” të nenit 42 të Kodit Zgjedhor, që u mohonte një të drejtë kushtetuese shtetasve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë territorit të Shqipërisë.

Vizioni im fokusohet në dy pika kryesore.

E para, është vijim i punës në një grup institucional, i ngritur me urdhër të Kryeministrit, për të përgatitur një paketë ligjore për mundësimin e votës së diasporës, ku kam bërë propozime konkrete. Unë besoj se mund të jap eksperiencën time për shkak se kam studiuar dhe i njoh shumë mirë gjuhët, si kroatishtja dhe rumanishtja dhe besoj që praktikat më të mira dhe fakti që janë të ngjashme me realitetin tonë mund të jenë të implementueshme.

Do të fokusohesha në dy nga detyrat kryesore që ka komisioni rregullator:

1. Mundësimi i votimit për shtetasit shqiptarë që ndodhen jashtë territorit të Shqipërisë, gjë që kërkohet, deri diku, edhe nga Komiteti Koordinues i Diasporës, që është ngritur me akt normativ, me VKM.

2. Implementimi i teknologjive të reja, e cila, po ashtu, është një specifike. Ne asokohe kemi bërë edhe propozime për modele, të cilat do të duhet më pas t'i vendosi KQZ-ja dhe ky komision rregullator, se si do të duhet të kryhet vetëdeklarimi i adresës.

Një nga praktikat dhe problematikat më të mëdha për implementimin e votës së shtetasve shqiptarë jashtë RSH-së është pikërisht fakti që ligji nr.14/2016 “Për identifikimin e adresarëve të shqiptarëve të cilët jetojnë jashtë vendit” nuk është duke u implementuar akoma ashtu siç duhet dhe jemi në një moment thelbësor, sidomos kur mbaron 10-vjeçari i pasaportave biometrike, ku në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse mundet që Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me konsullatat mund të intensifikojnë punën e tyre për t'i detyruar në një farë mënyre ose ndërgjegjësuar shqiptarët që të vetëdeklarojnë adresën e tyre dhe të mundën të jenë pjesë më pas, në bazë të një vetëdeklarimi dhe qëllimi të tyre të shprehur, e listave zgjedhore, si shtetas shqiptarë jashtë territorit.

**Damian Gjikhuri** – Ku jeni aktualisht?

**Elona Bano** – Aktualisht jam pedagoge dhe avokate. Funkcionoj në të drejtën administrative.

**Alket Hyseni** – E shoh se keni pasur një eksperiencë si shefe kabineti dhe pastaj si drejtore ekzekutive e agjencisë për një periudhë shumë të shkurtër. A mund të di arsyen e shkëputjes?

**Elona Bano** – Ishin shkaqe personale dhe për shkak të Covidit, që u detyrova të marr këtë vendim personal.

Faleminderit! Punë të mbarë!

**Damian Gjikhuri** – Zoti Lako, shumë shkurt, çfarë ju ka shtyrë të aplikoni për këto pozicione? Pra, flisni pak për eksperiencën tuaj dhe pse jeni i përshtatshëm qoftë për komisioner, rregullator dhe KAS? Ju keni aplikuar për të tria.

**Elvin Lako** – Faleminderit!

Në fakt, kam aplikuar vetëm për dy komisionet; duhet të jetë ndonjë gabim.

Për shkak të eksperiencës sime rreth 20-vjeçare në profesionin e juristit në administratën e lartë shtetërore, detyrave që kam kryer në të kaluarën, të përkushtimit që kam pasur gjatë gjithë karrierës sime dhe të rezultateve që kam arritur në punë gjatë gjithë kësaj periudhe, pasi u njoha me njoftimin që kishte bërë Kuvendi i Shqipërisë për këto pozicione, kryesisht për këto 2 komisione, formimi dhe eksperiencia ime në punë përshtatej me kërkesat

që ishin vendosur aty, vendosa të aplikoj duke menduar që aplikimi dhe kandidatura ime do të ishin një vlerë e shtuar për këtë komision dhe kontributi modest do të ndikonte në nxjerrjen e një rezultati sa më të drejtë dhe të një procesi më të rregullt, pra për të arritur të gjithë atë që kërkohet prej kohësh.

Shkurtimisht, kam filluar në vitin 1999 në aparatën e Këshillit të Ministrave në Departamentin Juridik të tij, kam punuar aty për një periudhë të gjatë kohore si jurist i Këshillit të Ministrave. Eksperienca aty ka qenë një eksperiencë e gjatë për sa i përket hartimit, përpilimit të marrjes së akteve. Janë të pakta aktet që janë sot në fuqi, të cilat nuk kanë kaluar nëpërmjet duarve tona, sepse ne me këtë punë merreshim kryesisht. Pra, për sa u përket komisioneve rregullatorë mendoj se është një detyrë që do ta bëja me kënaqësi, me përkushtim dhe do të kontribuoja atje, sepse edhe në pozicionin e fundit që kam qenë për një periudhë rreth 6-vjeçare kemi bërë një reformë të plotë me miratimin e rreth 25 akteve ligjore, nënligjore, prandaj, si të thuash, është specialiteti im pjesa e hartimit dhe e miratimit të akteve.

Edhe për komisionin tjetër, kam marrë pjesë në detyra të ndryshme për sa u përket bordeve, për shembull, kam qenë në pozicionin e drejtorit të Përgjithshëm të Pronësisë Industriale, si kryetar i Bordit të Apelit, që është gati si gjykatë për shqyrtimin e ankesave që vijnë, pra kam eksperiencë edhe në fushën e bordeve, të komisioneve për sa u përket ankesave. Mendoj se kandidatura ime do të ishte e përshtatshme, nëse do të vlerësohet nga ju si komision.

**Damian Gjikhuri** – Faleminderit!

Ka pyetje? Nuk ka

Suksese!

Natën e mirë!

Elvis Çefa ka aplikuar për nënkomisioner, për rregullator dhe KAS.

Mirëmbërëma, Elvis!

Ju keni aplikuar për 3 nga pozicionet që ka shpallur Kuvendi: nënkomisioner, rregullator dhe KAS. Shumë shkurt, pse eksperiencën tuaj profesionale përshtatet me një nga këto pozicione? Jo më shumë se 2 minuta, pasi dhe koha është e kufizuar.

**Elvis Çefa** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë,

Shkurtimisht do t'ju parashtroj arsyet pse mendoj se jam një person i përshtatshëm për të konkurruar në 3 pozicionet e shpallura nga Kuvendi, sikurse besoj jeni konsultuar edhe me dosjen time. Kam një eksperiencë si jurist prej pothuajse 24 vjetësh, nga të cilat 18

vjet i kam kaluar në administratën shtetërore dhe, për fatin tim, shumicën e tyre në institucione të rëndësishme të administratës shtetërore. Dëshiroj të theksoj këtu se kam pasur fatin të kem eksperiencë në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në Kryeministri, në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

Duke parë mënyrën e konceptimit të KQZ-së së re si një entitet, i cili ka pushtetin e tij legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, mendoj se përshtatem të punoj në pozicionin e nënkomisionerit për shkak se kam një eksperiencë në drejtim: në administratën shtetërore prej pothuajse 6 vjetësh, duke përfshirë 2 vjet e gjysmë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe mbi 3 vjet e gjysmë në Agjencinë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave.

Mendoj, gjithashtu, se jam i përshtatshëm për të qenë anëtar i rregullatorit, sepse gjatë gjithë kësaj periudhe 2 vjet e gjysmë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, por dhe në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në cilësinë e zëvendëskryetarit, anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe drejtorit të Përgjithshëm, kam hartuar apo kam marrë pjesë në hartimin e shumë rregulloreve, shumë akteve nënligjore të brendshme për të rregulluar qoftë punën në institucionin e Agjencisë për Kthimin e Pronave, qoftë dhe marrëdhëniet e sistemit gjyqësor, kur isha në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

Ndërsa për sa i përket pozicionit në KAS, që e shikoj edhe si gjyqësori i KQZ-së, mendoj se përshtatem për shkak se 3 vjet e gjysmë kur kam qenë drejtor i Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave kam dhënë dhe kam nënshkruar me mijëra vendime, të cilat, sipas interpretimit të Gjykatës së Lartë, por edhe të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut janë vendime gati gjyqësore, ndoshta më pëlqen mua ta interpretoj, pra kam dhënë vendime gati gjyqësore, ashtu siç duhet të jenë edhe vendimet që do të japë KAS-i gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Ju faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – A jeni larguar me ndonjë masë administrative?

**Elvis Çefa** – Po, zoti kryetar. Në jetën time kam marrë një masë administrative, që është shkarkimi nga detyra i anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, masë e cila është konstatuar nga gjykatat në të tria shkallët e gjyqimit e kundërligjshme dhe, si e tillë, është shfuqizuar. Pra, Kuvendi i Shqipërisë në vendimin nr. 79 të vitit 2014 ka shkarkuar 2 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi më parë dhe ky vendim është konstatuar i paligjshëm, është shfuqizuar nga gjykatat, deri nga Gjykata e Lartë.

**Damian Gjikhuri** – A ka pyetje?

**Oerd Bylykbashi** – Unë zotin Çefa e njoh personalisht, kam punuar me të dhe diçka që do të shtoja është edhe fakti që ka eksperiencë shumë të madhe edhe në shpjegimin e ankimit administrativ, kështu që është vlerë.

**Damian Gjikhuri** – Zoti Çefaj, natën e mirë!

**Elvis Çefa** – Ju faleminderit! Punë të mbarë!

**Damian Gjikhuri** – Emiliano Braho është kandidati i radhës.

Zoti Braho, ju keni aplikuar për dy trupa.

Po pra, në njërin e kemi skualifikuar. Është për Komisionin e Ankimit dhe Sanksioneve.

Shumë shkurt, na thoni pse mendoni se karriera juaj është e përshtatshme për këtë pozicion, dhe si e shikoni rolin tuaj.

Dy-tre minuta, sepse mund të ketë edhe ndonjë pyetje nga anëtarët.

**Emiliano Braho** – Unë kam mbaruar Fakultetin e Drejtësisë në vitin 2005. Që prej asaj periudhe kam ushtruar disa detyra shtetërore, por më tepër jam përqendruar në aktivitetin privat, në fushën e avokatisë. Kryesisht, çështjet në të cilat jam përqendruar kanë qenë çështje administrative, në kuadër të fushës së kërkuar, brenda kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga ligji i sotëm, i cili na jep sot të drejtën të kandidojmë.

Një nga këto është çështja administrative, e po ashtu çështje të ndryshme që unë kam përfaqësuar edhe në kolegjin zgjedhor, në subjektet politike që kanë qenë pjesë e zyrës në të cilën unë kam ushtruar detyrën e avokatit.

Në këto kushte, të nderuar, unë mendoj se i plotësoj kushtet dhe kriteret për t'u pranuar dhe për ta kryer më së miri këtë detyrë, të cilën e konsideroj si përgjegjësi.

**Adnor Shameti** – Unë doja të shprehja vlerësimin tim për aplikimin e kandidatit. E kemi njohur dhe mendoj se ka eksperiencën e duhur, pasi ka përfaqësuar subjekte politike në KQZ dhe në Kolegjin Zgjedhor, kështu që e vlerësoj si aplikim.

**Damian Gjikhuri** – Faleminderit!

U kuptua që votën e Adnorit e ke.

**Emiliano Braho** – Mirë atëherë! Faleminderit! Mirupafshim!

**Damian Gjikhuri** – Esmir Rigaj.

Zoti Rigaj, ju keni aplikuar për Komisionin e Ankimit dhe Sanksioneve.

Shumë shkurt, na flisni për background-in tuaj, si dhe përse e shikoni veten të përshtatshëm në këtë pozicion?

Mikrofonin, të lutem!

**Esmir Rrigaj** – Faleminderit! Jam Esmir Rigaj dhe vij nga qyteti i Pukës. Kam mbaruar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti Luigj Gurakuqi. Që nga viti 2012 deri në vitin 2019 kam ushtruar profesionin e avokatit. Nga fundi i 2019-ës e në vazhdim jam anëtar i Sekretariatit Teknik, te Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit.

Duke qenë se këto janë institucione të reja, të krijuara me ndryshimet në Kodin Zgjedhor, aplikova për të qenë anëtar i KAS.

**Adnor Shameti** – Një pyetje. Më fal, se s'jam i axhornuar tani: është pozicion full time apo është pozicion part time, ky juaji aty?

**Esmir Rrigaj** – Jo, është pozicion full time.

**Adnor Shameti** – Në rregull!

**Esmir Rrigaj** – Por aplikimi në këtë është i pjesshëm.

**Myslim Murrizi** – Jeni te vetingu i policisë, me zotin Baku, me Turin?

**Esmir Rrigaj** – Unë punoj me relatoren Mirela Ujkani.

**Myslim Murrizi** – Aha, nuk je komisioner aty?

**Esmir Rrigaj** – Jo, unë jam anëtar i Sekretariatit Teknik, jo komisioner.

**Myslim Murrizi** – Ah, je te sekretariati. Po një vit keni që keni filluar aty, çfarë ju shtyu të kandidoni këtu? Kuvendi ia zgjati afatin vetingut pa afat. E ka bërë maxhoranca që Vetingu i Policisë të jetë 200-300 vjet.

**Esmir Rrigaj** – Nuk më takon ta komentoj këtë, ndërsa ambicia ndaj vetes për të qenë...

**Myslim Murrizi** – Doni të kontribuoni më shumë?

**Esmir Rrigaj** – Po.

**Myslim Murrizi** – Faleminderit!

**Esmir Rrigaj** – Mirupafshim! Punë të mbarë!

**Damian Gjikhuri** – Më fal, ju jeni zoti Tafaj?

**Fatmir Tafaj** – Tafaj.

**Damian Gjikhuri** – Zoti Tafaj, ju keni aplikuar për Komisionin e Ankimit dhe Sanksioneve.

**Fatmir Tafaj** – Po.

**Damian Gjikhuri** – Shumë shkurt, na flisni për background-in tuaj, si dhe përse mendoni se është i përshtatshëm për këtë pozicion. Jo më shumë se dy minuta, se mund të ketë edhe pyetje.

**Fatmir Tafaj** – Në rregull!

Unë jam Fatmir Tafaj, i datëlindjes 14 korrik 1963, shtetësia shqiptare, vendlindja dhe vendbanimi në Tiranë, i martuar, baba i dy fëmijëve.

Edukimi im fillon që në vitin 1987, vit në të cilin u diplomova. Në vitin 2005 vazhdova studimet dhe u diplomova për Juridik. Më pas, me kalimin e kohës, fillova të merrja disa specializime, të cilat u shërbenin detyrave që kam kryer.

Jam i gatshëm për këtë pozicion, me arsyen se në vitin 2010 jam shpallur kandidatë fituese për anëtar të Komisionit të Shërbimit Civil, detyrë të cilën e kreu deri në vitin 2014. Gjatë kësaj periudhe, sipas rregullores së brendshme, u zgjodha nënkryetar i këtij komisioni, ndërkohë pas disa muajsh u zgjodha edhe kryetar. Ky pozicion ishte një sfidë e madhe për mua, megjithatë edhe me ndihmën e kolegëve të atij institucioni arritëm ta vëmë në funksionim këtë institucion, i cili ndoshta për disa nga ju njihet se në ç'pozita, në ç' kushte ishte ai institucion në ato vite. E vumë në funksionim dhe arritëm rezultate, të cilat na inkurajuan për ecjen e mëtejshme dhe trajtimin e dy objektivave kryesorë, në të cilën ishte ngritur ky institucion.

Objektivi i parë kishte të bënte me ankesat, me të gjitha mosmarrëveshjet administrative të administratës të nëpunësve civilë.

Objektivi i dytë kishte të bënte me mbikëqyrjen e administrimit të nëpunësve civilë.

Mendoj që kam dhënë kontribut modest dhe vetë rezultatet e arritura, vetë marrëdhëniet institucionale me Kuvendin, të cilat ishin ndërprerë me kohë me këtë institucion dhe me institucionet ndërkombëtare, them se janë një bonus për të cilin unë kërkoj të kandidoj për këtë pozicion. Mandati më është ndërprerë. Duhej të kisha një mandat 7 vjet e gjysmë. Me ndryshimin e ligjit m'u ndërpre mandati. Mendoj se ndoshta ka ardhur momenti që ta vazhdoj këtë mandat, pasi edhe ky institucion ka si objekt trajtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Faleminderit! Punë të mbarë!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Damian Gjikhuri** – Gjatë periudhës 2010-2014.

Vijojmë me zonjën Farie Osmani.

**Farie Osmani** – Mirëdita! Përshëndetje!

**Damian Gjikhuri** – Mirëmbërëma, zonja Osmani!

Shumë shkurt, ju keni aplikuar për pozicionin në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve: cila është eksperiencia juaj, çfarë ju shtyu, pse e shikoni veten të përshtatshme në këtë pozicion?



**Farie Osmani** – Faleminderit!

Më lejoni të jem shumë konçize. Po filloj me eksperiencën themelore. Në vitet 2003-2005 kam punuar pranë institucionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me kontrata të përkohshme, ku kam pasur mundësinë të jem specialiste vendimesh, specialiste prokurimesh, specialiste stenografe dhe punë të tjera. Ka qenë një eksperiencë e shkëlqyer, e cila më shërbeu më vonë. Po atë vit kam filluar punë si shefe kabineti, por edhe përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Funksioneve të Deleguara pranë institucionit të prefektit të qarkut të Tiranës për shtatë vjet deri në vitin 2013. Pastaj kam filluar pranë institucionit në varësi të Bashkisë Tiranë, Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit në detyrën e përgjegjëses së Sektorit Juridik.

Gjatë këtyre eksperiencave në punë si në institucionin e prefektit të qarkut të Tiranës, ashtu edhe pranë Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, kam pasur mundësinë, krahas detyrave dhe funksioneve të tjera, ta përfaqësoj institucionin edhe pranë gjykatës. Kjo ka shërbyer si një eksperiencë mjaft e mirë, në fakt, sepse në vitin 2017 unë fillova të ushtroj profesionin e lirë si avokate, punë që bëj edhe për momentin. Është një punë që po e bëj në përditshmërinë time. Kam disa çështje administrative, çështje pune, por edhe penale.

U entuziazmova kur pashë mundësi aplikimi, në fakt. Përgjatë disa zgjedhjeve, në vitet 2013, 2015 dhe 2017 kam pasur mundësinë të jem në pozicionet e anëtares së komisionit zonal të administrimit zgjedhor, atje ku unë aty banoj, në pozicionin e sekretares dhe të anëtares. Kjo ka qenë një eksperiencë e mirë që unë e kam bërë me angazhim e përkushtim.

Gjithashtu, kam marrë pjesë edhe në detyrën e komisioneres pranë qendrave të votimit kur janë zhvilluar zgjedhjet... E thashë edhe një herë, që të jem konçize, isha mjaft entuziaste kur pashë këtë aplikim.

Referuar mundësisë, ju mund ta shihni, pavarësisht dëshirës sime absolutisht shumë të madhe që të jem pjesë e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. E kam parë ligjin nr. 101/2020 dhe jam e kënaqur nëse do të jem pjesë.

**Damian Gjikhuri** – Nga administrata është konstatuar një mangësi për sa i përket deklaratës suaj, që ka përcaktuar komisioni në lidhje me konflikt interesi, të qenit anëtar partie. Ju lutem, thjesht për kujtesë, duhet ta plotësoni, nëse do të vazhdoni të tregoni interes për këtë pozicion. Më shumë mund të jetë një harresë, pra një mangësi, një pakujdesi që nuk besoj se ndikon për aq kohë sa ne ju thërritëm këtu. Kini parasysh që është një gjë që duhet plotësuar.

Ka ndonjë pyetje?

*(Deputeti Murrizi flet pa mikrofon.)*

**Farie Osmani** – Nuk do të jem.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Partinë Demokratike.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Patjetër, e them me dinjitet edhe këtë pjesë, edhe angazhimet.

Faleminderit!

Natën e mirë!

**Damian Gjikhuri** - Radhën e ka zoti Gentian Rumano.

Ju keni aplikuar për pozicionin e komisionerit të ankimeve dhe sanksioneve. Shumë shkurt, formimi juaj dhe pse jeni i përshtatshëm për këtë pozicion, nisur nga kriteret që ka përcaktuar ligji? Një prezantim të shkurtër, jo më shumë se dy minuta.

**Gentian Rumano** – Faleminderit!

Unë kam përfunduar Fakultetin e Drejtësisë në vitin 2004. Nga viti 2004 deri në vitin 2005 kam ushtruar profesionin e asistentit të avokatit, në një nga zyrat më prestigjioze të avokatisë në Tiranë. Më pas, në vitin 2006, kam marrë edhe titullin e avokatit, profesion të cilin e ushtroj nga viti 2006 deri sot që flasim. Gjatë gjithë kësaj kohe, mendoj se kam marrë një eksperiencë të mjaftueshme për të aplikuar në pozicionin e anëtarit të KAS-it, si një nga institucionet e reja që janë krijuar nga Kodi Zgjedhor, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Gjatë vitit 2012 deri në vitin 2017, kam qenë avokat pranë komisionit shtetëror të zyrës juridike, pranë Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka qenë dhe koha më voluminoze në çështjet administrative që kam ndjekur pranë Gjykatës Administrative. Kam shqyrtuar dhe përfaqësuar shumë çështje administrative, në shumicën e të cilave kam rezultuar edhe fitues. Kam fituar një eksperiencë të mjaftueshme, për të qenë anëtar i këtij komisioni dhe mendoj se mund të shërbejë.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Ka ndonjë pyetje? Jo.

Faleminderit!

Natën e mirë!

Radhën e ka, zoti Florian Beqaraj.

Ju keni aplikuar për Komision Rregullator dhe Komisionin e Ankimeve. Ju lutem, shumë shkurt, pse eksperiencia juaj është e përshtatshme për to? Pra, brenda 2 minutave një parashtrim të shkurtër.

**Florian Beqaraj** - Unë kam përfunduar studimet për jurisprudencë në vitin 2003 dhe që prej asaj kohe jam angazhuar me zgjedhjet, kam qenë komisioner i KZQV në njësinë

bashkiake nr.8 me seli në gjimnazin “Partizani”. Aty kam qenë komisioner i zgjedhjeve për 3 muaj, me detyrë sekretar. Kjo më ka shërbyer shumë për më tej për të konsoliduar njohuritë e mia në fushën e Kodit Zgjedhor dhe të legjislacionit në fushën e zgjedhjeve.

Më pas, kam punuar në Ministrinë e Drejtësisë, ku kam qenë shef i inspektimit të përmbartimit gjyqësor. Aty jam marrë me pjesën e hartimit të ligjit në fushën e përmbartimit gjyqësor privat. Kjo përvojë më ka shërbyer për pjesën e asaj që mendoj, pse duhet të jem anëtar i Komisionit Rregullator, sepse mendoj që eksperiencia ime është e konsoliduar në lidhje me hartimin dhe me zbatimin e ligjit. Më pas, në vitin 2010, kam themeluar një shoqëri përmbartimore private dhe jam licencuar si përmbartues gjyqësor privat dhe për gati 10 vjet kam punuar si menaxher i këtij aktiviteti në fushën e legjislacionit të zbatimit të drejtësisë. Kjo më ka dhënë shumë njohuri, një eksperiencë shumë të mirë dhe të pëlqyeshme, në fushën e zbatimit të ligjit dhe në studimin, analizën dhe mbarëvajtjen e çështjeve të drejtësisë. Kjo është edhe arsyeja, se përse unë mendoj që duhet të jem anëtar i Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve.

**Damian Gjikhuri** – Keni një formular që nuk e keni plotësuar, për sa i përket konfliktit të interesit, pra qenia anëtar i ndonjë partie politike apo ndonjë konflikt tjetër.

**Florian Beqaraj** – Nuk kam qenë asnjëherë anëtar i ndonjë partie politike.

**Damian Gjikhuri** – Radhën e ka zoti Haki Mustafa. Zoti Mustafa, shumë shkurt prezantimin, se pse keni aplikuar për një nga këto pozicionet, praktikisht komisioner, nënkomisioner dhe në Komisionin Rregullator, si dhe eksperiencia juaj në lidhje me përshatshmërinë për këto pozicione. Shumë shkurt, 2 deri në 3 minuta, sepse ne ju njohim, ju jeni deri diku person publik.

**Haki Mustafa** - Unë pashë vendet vakante dhe kërkova këto 3 pozicione. Kam qenë 3 vjet e gjysmë prefekt i Qarkut të Fierit, 15 vjet kam qenë kryetar i njësisë bashkiake. Kam eksperiencë të gjatë, sepse këto 19 vjet jam marrë me infrastrukturën e zgjedhjeve. Për arsye se nuk kam pasur asnjëherë asnjë kontestim, qoftë nga subjekte politike, qoftë nga institucione shtetërore, mendova të kandidoj.

**Damian Gjikhuri** – Je anëtar i ndonjë partie?

**Haki Mustafa** – Patjetër. Unë të gjitha pozicionet i kam pasur politike. Edhe aty thuhet që të jesh funksionar politik.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Natyrisht koha na thinj, por ashtu ka qenë.

Kryesorja është që kudo ku kam shkuar nuk kam pasur asnjëherë kontestim për asgjë.

**Myslým Murrizi** – Unë ruaj konsideratë për ju si prefekt i qarkut Fier dhe si kryetar i minibashkisë. Je i sinqertë kur thua që je anëtar partie, sepse të gjithë këta që vijnë këtu janë anëtarë partie. Ajo letër as ta heq dhe as ta shton tifozllëkun. Ata që thonë që nuk janë anëtarë partie, janë më shumë sesa ata që thonë jemi.

Faleminderit!

**Haki Mustafa** – Mirupafshim!

**Damian Gjikhuri** – Halil Hyseni ka aplikuar për komisioner.

Zoti Hyseni, ju lutem prezantoni shumë shkurt, për dy-tre minuta, eksperiencën tuaj, çfarë ju shtyu të aplikoni dhe pse mendoni se jeni i përshtatshëm për pozicionin e komisionerit?

**Halil Hyseni** – Quhem Halil Hyseni dhe, ashtu siç e thatë edhe ju, kam aplikuar për komisioner shtetëror të zgjedhjeve.

Aktualisht jam pedagog në Universitetin Metropolitan të Tiranës, ku jap lëndën e së Drejtës. Gjatë jetës sime kam mbajtur detyra të ndryshme dhe kam shërbyer si në sektorin civil, ashtu edhe në atë shtetëror. Në sektorin shtetëror kam qenë pedagog, drejtor i kabinetit të ministrit të Jashtëm, drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil, zëvendësministër i Punëve të Jashtme dhe tani aspiroj për më shumë, kurse në sektorin privat kam punuar si përkthyes i autorizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe si avokat.

Për sa u përket arsyeve pse kam aplikuar, unë besoj që i plotësoj kriteret e nevojshme për ta përmbushur me nder këtë punë. Të gjitha punët deri tani unë i kam përmbushur me nder dhe besoj se nëse do të kërkonit një rekomandim nga ish-ministri Bushati apo ish-ministri Mustafaj apo i ndieri Olldashi, për të cilët kam punuar, do ta jepnin një rekomandim pune për mua. Pra, besoj se i përmbush kriteret e nevojshme morale dhe profesionale për këtë pozicion.

Për sa i përket arsimimit tim ai është divers. Si fillim kam shkuar në Shkollën e Aviacionit për pilot, kam vazhduar Akademinë Ushtarake, Kolegjin e Mbrojtjes, Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, *ER Law Neuchatel*, Zvicër. Besoj që ky diversifikim midis edukimit ushtarak dhe edukimit juridik më jep disa doza të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, të cilat vlejnë për vendin që kam aplikuar. Pra, për të mos ju marrë më shumë kohë, këto janë arsyet pse unë mendova të aplikoj. Edhe për shkak të punës, unë e kam parë me vëmendje bazën ligjore, por kjo është një gjë për t'u parë në vijim e sipër.

Faleminderit!

**Damian Gjikhuri** – Mirëmbërëma!

Zonja Vukaj ka aplikuar për të gjitha pozicionet: komisioner, nënkomisioner, rregullator dhe KAS.

Ju lutem, shumë shkurt, për dy-tre minuta, bëni një prezantim të vetes suaj, pse e shikoni veten të përshtatshme dhe cila është eksperiencia juaj për këto pozicione?

**Helga Vukaj** - Mirëmbërëma të gjithëve dhe faleminderit për këtë dëgjësë!

Unë quhem Helga Vukaj dhe kam një eksperiencë 20-vjeçare në punë. Jam diplomuar si juriste në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tiranës në vitin 2000. Më pas jam diplomuar në master të “Luigi Bocconi” në Milano, ku për shkak të rezultateve jam angazhuar si docente e jashtme. Këtu nis edhe karriera akademike, e cila ka ecur përkrah eksperiencës në administratën shtetërore në institucionet më të larta në vend dhe administratën publike.

Kam filluar karrierën në administratë shtetërore si pjesë e kabinetit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë në vitin 2003, Presidentit Moisiu, ku kam pasur një angazhim të drejtpërdrejtë në verifikimin e kushtetutshmërisë dhe dekretimin e akteve, kompetencë e Presidentit të Republikës.

Më pas karriera ime ka vijuar si Drejtoreshë e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Brendshme, ku kam kontribuar dhe kemi çelur siparin e të famshmit moratorium. Pra, kam kryesuar grupin e punës për draftimin e këtyre akteve. Përveç moratoriumit, të suksesshme kanë qenë edhe aktet që shoqëruan krijimin e pasaportës biometrike dhe shumë akte të tjera, të cilat shoqëruan reformat e asaj kohe, si ligji për Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, Gjendjen Civile dhe shumë ligje të tjera.

Përpos kësaj eksperience, jam afruar me eksperiencën administrative, por edhe atë civile duke marrë detyrën e zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Kthimit të Pronave, ku kam një kontribut të meritueshëm në krijimin e akteve të Agjencisë së Kthimit të Pronave dhe, për më tepër, në atë të ashtuquajturin vlerësim ligjor si format tekniko-ligjor dhe administrativ që shoqëronte vendimmarrjen, por që aplikohet gjerësisht sot edhe nga administrata publike që merret me këto çështje. Eksperiencia këtu ka zgjatur për 6 vjet, ku unë jam marrë me hetimin dhe verifikimin e ligjshmërisë, hetimin administrativ dhe pjesë e rëndësishme e vendimmarrjes kuazigjyqësore të asaj periudhe.

Më pas karriera ime, e vlerësueshme deri në atë moment, ka vijuar me pozicionin e drejtorit të Përgjithshëm në Kontrollin e Lartë të Shtetit, ku kam pasur një rol deciziv në formatimin dhe draftimin e akteve për raporte të konsoliduara dhe për mungesë anatemi nga ana e subjekteve, të cilat ishin objekt i veprimtarisë së KLSH-së. Në të njëjtën kohë, kam luajtur rol të rëndësishëm në draftimin e ligjit të KLSH-së, ku kam insistuar me ngulm që implementimi i hetimit dhe i procedimit hetimor administrativ të jenë pjesë integrale e fushës

së auditimit dhe nuk duhen parë si të veçuara, por si komponentë të lidhur bashkë. Pra, kontributi në draftim ka ecur përkrah me kontributin akademik, ku shkrimet akademike, shkencore, të nivelit shkencor internacional dhe kombëtar, janë të shumta.

Së fundi, kam botuar librin e tretë, i cili ka të bëjë me regjimin juridik të administrimit të aseteve. Këto më kanë shoqëruar paralelisht edhe me ngritjen akademike si “doktor shkencash” dhe mbaj gradën “profesor i asociuar”.

Jam e angazhuar në fakultetet e drejtësisë, në të Drejtën Administrative në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Nju Jorkut në Tiranë, në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin Luarasi, në Universitetin Shtetëror prej shumë vitesh dhe në kampet e tjera akademike, siç është Shkolla e Magjistraturës.

Detyra e fundit, e cila arrin në një pikë “karriere” është ajo e ministrit teknik të Financave, ku, falë integritetit profesional dhe personal, kam kontribuar në përmbushjen e detyrës së ngarkuar, nga vullneti i shprehur bipartizan i dy palëve apo i dy forcave kryesore politike, për të qenë monitorues apo rojtarë të shenjtërisë së saj, votës së lirë. Në funksion të ruajtjes së votës dhe mospërfshirjes së administratës, bashkë me ministrat teknikë në detyrë ne kemi përcjellë një raport, i cili ka marrë një vlerësim tejet pozitiv nga OSBE-ODIHR-i dhe është përshëndetur për vijim dhe angazhim të palëve në rekomandimet e lëna.

**Alket Hyseni** – Dua t’ju them se duhet të jemi të nderuar për një kandidaturë të tillë. Unë e njoh personalisht Helgën dhe nuk kam asnjë pyetje, por dua t’i shpreh mirënjohjen që ka bërë aplikimin dhe mendoj se, nëse gjen dakordësinë, kjo është një kandidaturë më se e kompletuar, që do t’i bëjë nder çdo institucioni. Kjo është një thirrje edhe për kolegun e opozitës.

**Myslim Murrizi** - Zoti Hyseni, po të jetë dakord partia juaj, flisni me zotin Rama, edhe ne dakord jemi, sepse nga partia jonë vjen. Nëse i qëndroni me votë kësaj që sapo thatë me fjalë... Do ta shikojmë te seanca. Ju po i drejtoheni Oerdit, por Oerdi nuk ka të drejtë vote, kështu që m’u drejto mua dhe Edmondit, ta votojmë me qejf dhe ta quajmë të kryer kandidaturën e Helgës.

**Oerd Bylykbashi**- Përgjatë kohës që unë kam shërbyer në administratën e lartë publike, zonja Vukaj ka shërbyer në funksionin që tha me një rekord shërbimi, të cilin besoj se edhe kolegët e tjerë e kanë parasysh.

Kështu që unë e falënderoj për aplikimin!

**Damian Gjikhuri** - Dua t’ju jap një eksperiencë timen, kur aplikojta për një pozicion në organet e drejtësisë, të gjithë thanë: “Po, le të hedhim të tjerët në votë të fshehtë”. Si përfundim, nuk mora asnjë votë.

Mirëmbërëma!

Ju lutem, shumë shkurt, sepse ne ju njohim, por na thoni pse vendose të kandidosh!

**Hysen Osmanaj-** Në radhë të parë, unë vendosa të kandidoj, sepse kam një eksperiencë të gjatë në zgjedhje, që në muajin tetor të vitit 1996, në zgjedhjet e pushtetit vendor. Njëkohësisht, kam qenë vëzhgues ndërkombëtar në zgjedhje, ku kam përfaqësuar disa organizata, edhe në zgjedhjet e para në Bosnje si vëzhgues ndërkombëtar. Kam edhe disa trajnime në disa shtete dhe nga disa organizata ndërkombëtare, duke filluar nga Bashkimi European, OSBE-ja, WEB-i e të tjerë. Kam eksperiencë të gjatë edhe në administratë publike, duke filluar nga pozicioni specialist deri në pozicionin drejtor i përgjithshëm, si dhe anëtar në këshillat, në njësitë bashkiake në Bashkinë e Tiranës dhe në këshillin e rretheve. Kam eksperiencë të gjatë qoftë në draftimin, qoftë në miratimin e ligjit. Të gjithë këtë eksperiencë timen, në kuadër të zgjedhjeve të lira dhe demokratike, mendoj ta jap.

**Oerd Bylykbashi-** Dua të shpreh konsideratën time për zotin Osmanaj. Eksperienca e zotit Osmanaj është publike dhe nuk ka nevojë të provohet.

Zoti Osmanaj është ndër të paktët kandidatë me një eksperiencë kaq të gjatë në administrimin e zgjedhjeve, jo thjesht në nivele të mesme, por në administrim në të tre komponentët, në të cilët po ngremë sot Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në atë rregullator, administrim dhe gjykim administrativ në rolin kuazi gjyqësor që KQZ-ja ka.

**Damian Gjijnuri-** Këtu përfundon pjesa e parë dhe nesër në orën 16:00 vazhdojmë me pjesën e dytë, që besoj se do të na marrë po kaq kohë.

Duhet t'i kemi gati të gjitha këto që dolën gjatë intervistave, sidomos ato që janë anëtarë partie, në mënyrë që të bëjmë vlerësimin.

## **MBYLLET MBLEDHJA**